

VENDIM

Nr.236, datë 6.3.2009

PËR KRIJIMIN E QENDRËS NDËRUNIVERSITARE TË ZHVILLIMIT TË TELEMATIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9704, datë 2.4.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet” dhe të nenit 6 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës, për nxitjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, me statusin e personit juridik, publik. Qendra Ndëruniversitare e Zhvillimit të Telematikës ka autonomi administrative dhe ekzekutive.
2. Qendra Ndëruniversitare e Zhvillimit të Telematikës do t’u shërbejë universiteteve shqiptare për përmirësimin e transmetimit të dijeve, të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
3. Detyra kryesore e Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës është administrimi i rrjetit telematik, akademik shqiptar.
4. Qendra Ndëruniversitare e Zhvillimit të Telematikës, fillimisht, do të mbulojë nevojat e tri universiteteve publike të Tiranës: Universitetit të Tiranës, Universitetit Politeknik dhe Universitetit Bujqësor, e më pas do të zgjerohet, për të mbuluar nevojat e të gjitha universiteteve të tjera shqiptare.
5. Qendra Ndëruniversitare e Zhvillimit të Telematikës do ta ketë selinë në Tiranë, në ndërtesën qendrore të Universitetit Politeknik.
6. Pranë kësaj qendre do të funksionojë Komiteti i Programimit dhe Drejtimit, i përbërë nga:

a) Ministri i Arsimit dhe Shkencës	kryetar;
b) Drejtori i Arsimit të Lartë, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës	anëtar;
c) Tre përfaqësues të universiteteve shqiptare	anëtarë;
ç) Një përfaqësues i konferencës së rektorëve italianë	anëtar.
7. Funksionet e Komitetit të Programimit dhe Drejtimit janë:

a) Miratimi i planeve operative gjashtëmujore.
b) Miratimi i raporteve të veprimtarive tekniko-administrative.
c) Hartimi i propozimeve të mundshme të drejtimeve të reja, për projektin fillestar të veprimtarive, në funksion të rezultateve të arritura ose të një evolucioni të kontekstit të përgjithshëm.
8. Organet dhe autoritetet drejtuese të Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës janë:

a) drejtori;
b) një ekspert me përvojë në fushën e metodologjisë dhe të projektimit didaktik-kurrikular;
c) një ekspert me përvojë në fushën e administrimit të rrjetit telematik dhe të programeve kompjuterike;
ç) një ekspert në fushën juridiko-ligjore dhe të procedurave të administrimit të fondeve europiane.

Qendra përbëhet edhe nga tri njësi mbështetëse, për shërbimin e sekretarisë, të përkthimit dhe të kontabilitetit.

- 9. Drejtori dhe tre ekspertët shqiptarë emërohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të një konkursi publik.**
- 10. Procedurat dhe rregullat e funksionimit të Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës përcaktohen në statutin e qendrës, i cili miratohet me akt nënligjor.**
- 11. Efektet financiare për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Ndëruniversitare të Zhvillimit të Telematikës do të përballohen sipas përcaktimeve të bëra në marrëveshjen, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të rrjetit telematik për universitetet.**
- 12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA